

URDHËR
Nr. 6079, datë 14.10.2015

**PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 279, DATË 14.6.2012 TË MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE NOTERIALE”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 26, të ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994, “Për noterinë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në aneksin 1, bashkëlidhur urdhrit nr. 279, datë 14.6.2012 të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e tarifave të shërbimeve noteriale”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë vijon:

a) Në listën e shërbimeve noteriale, shtohet shërbimi i mëposhtëm:

Emërtimi i shërbimit	Tarifa
Regjistrimi i subjekteve të biznesit	300 lekë

2. Ngarkohen të gjithë noterët për zbatimin e këtij urdhri, si dhe afishimin e tij në një ambient të dukshëm në zyrën noteriale.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë që, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë, të bëjë njoftimin e këtij urdhri dhe ndjekjen e zbatimit të tij në vijimësi.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço